



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 30 maj 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq dhe Flora Brovina.

Mungoi: Liburn Aliu.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi dhe Florie Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16. 05. 2012;**
- 3. Raportimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit të Punës;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16. 05. 2012

Kryesuesi konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.05.2012 u miratua pa vërejte.

3. Raportimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit të Punës

Fikrim Damka- Tha se do të ishte mirë që monitorimi i Ligjit të punës të kryhet para pushimeve. Pra, deri atëherë duhet ta shkruajmë raportin e monitorimit.

Time Kadriaj- Deklaroi se deri në fund të qershorit do të dalim me raport të monitorimit të këtij ligji.

Salihe Mustafa- Deklaroi se do të ishte mirë që sot të përcaktohem i se cilin vend tjetër do ta vizitojmë për monitorimin e këtij ligji.

Bahri Thaçi- Tha se me vizitat e bëra e kemi krijuar një pasqyrë rreth zbatimit të këtij ligji.

4. Të ndryshme

Time Kadriaj- E informoi Komisionin për një ftesë që e ka marrë nga përfaqësuesit e Fondit të sigurimeve shëndetësore nga Maqedonia. Ata kanë shprehur vullnetin të na presin në një takim.

Fikrim Damka- Tha se ka biseduar me UNICEF- in dhe ata kanë shprehur vullnetin për të na përkrahur në realizimin e kësaj vizite.

Flora Brovina- Tha se pasqyrimi i punës sonë nuk po bëhet në mënyrën e duhur në faqen e Kuvendit. Komisioni është më i rëndësishëm se grupi i grave. Ne po bëjmë punë të madhe dhe duhet ta informojmë opinionin.

Salihe Mustafa- Deklaroi se duhet të pasqyrohen edhe aktivitetet e Komisionit që zhvillohen në terren.

Fikrim Damka- Duhet të shikojmë se si mund të zgjidhet kjo çështje e pasqyrit të aktiviteteve tona.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka